



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

**THIRRJE PËR APLIKIM PËR PËR PROGRAMET FULBRIGHT PËR VITIN  
AKADEMIK 2026-2027**

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë ka hapur thirrjen për aplikim për programet Fulbright për vitin akademik 2026-2027.

**Programi Fulbright për Studime Master**

**Program 1-2 vjeçar për profesionistë të rinj që kanë përfunduar studimet, të interesuar të ndjekin studime në nivelin Master në Shtetet e Bashkuara.**

**Afati i Aplikimit:** 30 qershor 2025

**Bursat Fulbright të financuara nga Departamenti i Shtetit:**

- Janë të hapura për të gjitha fushat e studimit.

**Bursat Fulbright me financim nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë:**

- Janë të hapura për fushat e mëposhtme:
  - STEM (Shkencë, Teknologji, Fizikë, Matematikë)
  - Bujqësi dhe Shkencat e Jetës (Bujqësi e qëndrueshme dhe menaxhimi i burimeve, Menaxhimi i sistemeve bujqësore, Edukimi bujqësor, Menaxhimi i biznesit bujqësor, Ekonomia bujqësore, Inxhinieri bujqësore dhe biologjike, Ushqyerja e kafshëve, Biokimi, Biologji Molekulare, Entomologji dhe Patologji e bimëve)
  - Turizëm (Menaxhim i Turizmit, Turizëm i Trashëgimisë dhe Konservimi)
  - Inxhinieri Mjedisore (Inxhinieri e Resurseve Mjedisore, Menaxhim Mjedisor)
  - Inxhinieri (Inxhinieri Minerare dhe Gjeologjike, Inxhinieri Kimike, Menaxhim i Inxhinierisë së Qëndrueshme)
  - Bio-Kimi (Biokimi, Kimi Mjedisore, Bioteknologji Mjedisore, Shkenca e Bimëve)

**Kriteret për Aplikim:**

- Të jenë qytetarë të Republikës së Shqipërisë.
- Të kenë të paktën një diplomë të nivelit Bachelor nga një program studimi me kohë të plotë katër vjeçar (ose diplomë të programeve 3+1 ose 3+2 sipas sistemit të Bolonjës).
- Të kenë të paktën dy vjet përvojë profesionale pune në fushën e studimit dhe të shfaqin aftësi udhëheqëse.
- Të kenë një nivel të mirë të gjuhës angleze të folur dhe të shkruar (ekuivalente të nivelit B2-minimum 82 pikë, rezultatet e provimit të TOEFL nuk janë të detyrueshme në momentin e aplikimit).
- Të kualifikohen për të marrë vizë J-1.
- Të kenë rekorde të mira shëndetësore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

- **Detyrim për t'u kthyer në Shqipëri për të paktën dy (2) vjet pas përfundimit të programit.**

Për më shumë informacion lutem të vizitoni:

[Fulbright Foreign Student Program 2026 – 2027 - U.S. Embassy in Albania](#)

Për pyetje të tjera kontaktoni: [CultureandEducationTirana@State.Gov](mailto:CultureandEducationTirana@State.Gov)

### **Programi Fulbright për Studiues**

**Program post-doktoral, tre deri në gjashtë muaj, mundësi për studiues të rinj dhe/apo me më shumë përvojë, lektorë të universitetit, ekspertëve nga institucione akademike dhe kërkimi, për kërkime dhe/ose mësimdhënie në një universitet në Shtetet e Bashkuara.**

**Afati i Aplikimit:** 30 qershor 2025

#### **Fushat e Studimit:**

- Aplikimet janë të hapura për të gjitha fushat e studimit.

#### **Kriteret për Aplikim:**

- Të jenë qytetarë dhe banorë të Republikës së Shqipërisë.
- Të kenë gradën Doktor në fushën e tyre të studimit.
- Të kenë të paktën pesë vjet përvojë mësimdhënie dhe/ose kërkimore në një universitet shqiptar ose institucion tjetër kërkimor.
- Të kenë një nivel të mirë të gjuhës angleze të folur dhe të shkruar (ekuivalente të nivelit B2).
- Të kualifikohen për të marrë vizë J-1.
- Të kenë rekorde të mira shëndetësore.
- **Detyrim për t'u kthyer në Shqipëri për të paktën dy (2) vjet pas përfundimit të programit.**

Për më shumë informacion lutem të vizitoni:

[Fulbright Visiting Scholar Program 2026 – 2027 - U.S. Embassy in Albania](#)

Për pyetje të tjera kontaktoni: [CultureandEducationTirana@State.Gov](mailto:CultureandEducationTirana@State.Gov)

**SUKSESE!**